

VENDIM
Nr.56, datë 29.1.2004

**PËR HAPJEN E VENDKALIMIT TË RI KUFITAR NË DOBRUNË, HAS NË KUFIRIN
SHTETËROR, TOKËSOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ME KOSOVËN**

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 3 të nenit 24 të ligjit nr.8772, datë 19.4.2001 “Për ruajtjen dhe kontrollin e kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e vendkalimit të ri kufitar në Dobrunë, Has në kufirin shtetëror, tokësor të Republikës së Shqipërisë me Kosovën për komunikacion kufitar.

2. Ngarkohen Ministria e Rendit Publik, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano